



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.65

2006

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr. 9531, datë 11.5.2006	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.....	1783
Vendim i Kuvendit nr.45, datë 19.6.2006	Për mosmiratimin e dekretit nr.4894, datë 6.6.2006 të Presidentit të Republikës “Për kthimin e ligjit nr.9531, datë 11.5.2006 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë””.....	1787
Vendim i KM nr.362, datë 14.6.2006	Për disa ndryshime në vendimin nr.456, datë 3.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për strukturën dhe nivelet e pagave të punonjësve të administratës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë”	1787
Vendim i KM nr.364, datë 14.6.2006	Për disa ndryshime në vendimin nr.185, datë 16.4.1993 të Këshillit të Ministrave “Për pagat dhe shtesat mbi pagë të ushtarakëve të shërbimit pyjor”, të ndryshuar.....	1788
Vendim i KM nr.365, datë 14.6.2006	Për disa ndryshime në vendimin nr.108, datë 11.2.2005 të Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e organizimit, të funksionimit dhe pagat e punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave”.....	1789
Vendim i KM nr.366, datë 14.6.2006	Për pagat e punonjësve të Policisë së Burgjeve.....	1790
Vendim i KM nr.367, datë 14.6.2006	Për disa ndryshime në vendimin nr.21, datë 7.1.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës, të organikës dhe të pagave të punonjësve të Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave dhe të komisioneve vendore”.....	1791
		

Vendim i KM nr.368, datë 14.6.2006	Për disa ndryshime në vendimin nr.56, datë 27.2.1992 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të ushtarakëve të Shërbimit Informativ Kombëtar”, të ndryshuar.....	1793
Vendim i KM nr.369, datë 14.6.2006	Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve të sistemit tatimor.....	1794
Vendim i KM nr.370, datë 14.6.2006	Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të administratës së prefektit.....	1797
Vendim i KM nr.371, datë 14.6.2006	Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të disa institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit.....	1799
Vendim i KM nr.374, datë 14.6.2006	Për shpronësimin për interes publik të pronarit të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga rikonstrukcioni i rrugës së lagjes “Dëllinjë”, në bashkinë e Gramshit.....	1801
Vendim i KM nr.376, datë 14.6.2006	Për disa ndryshime në vendimin nr.205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar..	1803
Udhëzim i KM nr.4, datë 14.6.2006	Për një ndryshim në udhëzimin nr.1, datë 1.1.1996 të Këshillit të Ministrave “Për prokurimin publik”, të ndryshuar	1804
Vendim i ERE nr.34, datë 12.6.2006	Për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, për vitin 2005, për shoqërinë “Emikel” sh.p.k.....	1804
Vendim i ERE nr.35, datë 12.6.2006	Për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për vitin 2005, për shoqërinë “Maksi Elektrik” sh.p.k.....	1805
Vendim i ERE nr.36, datë 12.6.2006	Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e tarifave të lidhjeve të reja në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike	1805
Vendim i ERE nr.37, datë 13.6.2006	Për miratimin e kërkesës së shoqërisë “Kurum International” sh.p.k. për të qenë klient tarifor.....	1813
Vendim i ERE nr.38, datë 13.6.2006	Për dhënien e licencës për aktivitetin e importit të energjisë elektrike shoqërisë “Wonder Power” sh.a.....	1813

L I G J
Nr. 9531, datë 11.5.2006

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8410, DATË 30.9.1998 “PËR
RADION DHE TELEVISIONIN PUBLIK E PRIVAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 8 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 8

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit përbëhet nga Kryetari, Zëvendëskryetari dhe 3 anëtarë nga radhët e personaliteteve në fushat e politologjisë, drejtësisë, medias, sociologjisë apo shkencave të tjera humanitare, të cilat kanë lidhje ose ndikojnë drejtpërdrejt mbi qëllimet e veprimtarisë radiotelevizive, siç përcaktohet në nenet 35 e 36 të këtij ligji.

KKRT-ja ushtron veprimtarinë në përputhje me këtë ligj nën mbikëqyrjen e Kuvendit.

Funksioni i Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit të KKRT-së është me kohë të plotë e i papajtueshëm me çdo detyrë ose funksion tjetër publik e privat, me përjashtim të mësimdhënies.

Paga e Kryetarit, Zëvendëskryetarit, si dhe masa e shpërblimit mujor për 3 anëtarët e Këshillit përcaktohen nga Kuvendi.

Neni 2

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 9

1. Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit zgjidhen nga Kuvendi për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik i propozon Kuvendit 2 kandidatura alternative për çdo vend anëtar të KKRT-së, pas një përzgjedhjeje mes të paktën 4 kandidaturave të propozuara nga subjektet përkatëse si më poshtë:

a) 1 anëtar zgjidhet nga kandidaturat e propozuara nga shoqatat dhe grupimet e mediave elektronike;

b) 1 anëtar zgjidhet nga kandidaturat e propozuara nga shoqatat e medias së shkruar;

c) 1 anëtar zgjidhet nga kandidaturat e propozuara nga profesorati dhe shoqatat e inxhinierisë elektrike dhe elektronike;

ç) 1 anëtar zgjidhet nga kandidaturat e propozuara nga profesorati i së drejtës, shoqatat e juristëve dhe Dhoma Kombëtare e Avokatisë;

d) 1 anëtar zgjidhet nga kandidaturat e propozuara nga subjektet parlamentare.

2. Për përzgjedhjen e 2 kandidaturave alternative për çdo vend anëtar të KKRT-së, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik zbaton procedurën e mëposhtme:

Kandidaturat e administruara, në bazë të propozimeve të subjekteve përkatëse në Komision, i nënshtrohen përjashtimit një nga një deri në mbetjen e 2 të tillave, të cilat i propozohen seancës plenare. Procedura e përjashtimit zbatohet sipas radhës: një nga përfaqësuesit e maxhorancës parlamentare në Komision dhe një nga përfaqësuesit e opozitës.

3. Kandidatët për anëtarë, të zgjedhur nga fushat e caktuara sipas nenit 8 të ligjit, përzgjidhen ndërmjet personaliteteve që kanë tituj të lartë nderi (dekorata), sipas ligjit nr. 8113, datë 28.3.1996 “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë”, tituj e grada shkencore apo kualifikime të ngjashme, ose që janë autorë veprash dhe publikimesh në fushat e mësipërme. Kandidatët e përzgjedhur duhet të mos jenë larguar nga shërbimi civil, detyra apo funksioni publik si pasojë e një mase disiplinore.

4. Kandidaturat e propozuara nga subjektet e përcaktuara në shkronjën “c” të pikës 1 duhet të kenë grada ose tituj shkencorë.

5. Kuvendi, me votim të hapur, zgjedh njërin nga anëtarët e Këshillit në detyrën e Kryetarit të KKRT-së, ndërsa Zëvendëskryetari zgjidhet nga KKRT-ja me votim të fshehtë.

Në mënyrë që të sigurohet vijimësia e funksionimit të KKRT-së, gjatë mandatit të parë të tij, Kryetari dhe Zëvendëskryetari i KKRT-së zgjidhen në funksion për një periudhë 5-vjeçare, ndërsa 3 anëtarët e tjerë për një periudhë 3.5-vjeçare.”.

Neni 3

Në nenin 12 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Jo më vonë se tre muaj para fillimit të çdo viti fiskal, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit harton një fond të shpenzimeve operative të parashikuara dhe ia paraqet për miratim Këshillit të Ministrave.”.

Neni 4

Në nenin 14 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Të jenë anëtarë të partive dhe shoqatave politike, si dhe të kenë ushtruar detyrën e kryetarit të bashkisë, deputetit, anëtarit të Këshillit të Ministrave apo të prefektit gjatë 2 legjislaturave të fundit ose të kenë konkurruar për kryetar bashkie apo deputet në zgjedhjet e organizuara për to.”.

2. Në pikën 2, fjala “anëtarë” zëvendësohet me fjalët “aksionerë, anëtarë të organeve drejtuese, të punësuar”.

Neni 5

Në fund të pikës 1 të nenit 15 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“- kur në mënyrë të përsëritur mbi 2 herë radhazi, me dashje ose për shkak të neglizhencës, pengon formimin e kuorumit të nevojshëm për mbledhjen e KKRT-së. Kryetari, Zëvendëskryetari ose të paktën 2 anëtarë të Këshillit i drejtojnë Kuvendit kërkesën e arsyetuar për lirin nga detyra. Kuvendi shqyrton kërkesën brenda 10 ditëve.”.

Neni 6

Paragrafi i parë i nenit 17 ndryshohet si më poshtë:

“Vendimet, rekomandimet, vërejtjet dhe opinionet e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit miratohen në mbledhje me votën pro të 3 anëtarëve.”.

Neni 7

Në nenin 20 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Një person fizik ose juridik, që ka aksione në një shoqëri radio ose televizive, nuk lejohet që, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të marrë pjesë në prokurimet me fondet publike të shtetit, njërive të pushtetit vendor ose shoqërive me kapital shtetëror, si dhe në procesin e privatizimit të pronës publike.”.

Neni 8

Neni 87 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 87

Anëtarët e Këshillit Drejtues të Radios dhe Televizionit zgjidhen nga radhët e personaliteteve në fushat e politologjisë, drejtësisë, medias, sociologjisë ose shkencave të tjera humanitare, të cilat kanë lidhje apo ndikojnë drejtpërdrejt mbi qëllimet e veprimtarisë radiotelevizive, siç përcaktohet në nenet 35 e 36 të këtij ligji. Kriteri parësor për përzgjedhjen e këtyre personaliteteve është mbajtja e titujve të nderit (dekorata), sipas ligjit nr.8113, datë 28.3.1996 “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, titujve apo gradave shkencore ose kualifikimeve të ngjashme, apo që janë autorë veprash dhe publikimesh në fushat e mësipërme. Anëtarët e Këshillit Drejtues të Radios dhe Televizionit duhet të mos jenë larguar nga shërbimi civil, detyra ose funksioni publik si pasojë e një mase disiplinore.”.

Neni 9

Neni 88 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 88

1. Këshilli Drejtues i RTSH-së përbëhet nga 7 anëtarë, të cilët zgjidhen nga Kuvendi pas një përzgjedhjeje në bazë të propozimeve të subjekteve përkatëse të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.

2. Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik i propozon Kuvendit 2 kandidatura alternative për çdo vend anëtar të Këshillit Drejtues të RTSH-së, pas një përzgjedhjeje mes të paktën 4 kandidaturave të propozuara nga subjektet përkatëse si më poshtë:

a) 1 anëtar zgjidhet nga kandidaturat e propozuara nga shoqatat e grupimet e mediave elektronike dhe shoqatat e medias së shkruar;

b) 1 anëtar zgjidhet nga kandidaturat e propozuara nga Universiteti i Tiranës;

c) 1 anëtar zgjidhet nga kandidaturat e propozuara nga profesorati dhe shoqatat e inxhinierisë elektrike dhe elektronike;

ç) 1 anëtar zgjidhet nga kandidaturat e propozuara nga shoqatat e juristëve dhe Dhoma Kombëtare e Avokatisë;

d) 1 anëtar zgjidhet nga kandidaturat e propozuara nga subjektet parlamentare;

dh) 1 anëtar zgjidhet nga kandidaturat e propozuara nga organizatat joqeveritare për të drejtat e njeriut dhe për të drejtat e fëmijëve;

e) 1 anëtar zgjidhet nga kandidaturat e propozuara nga këshillat miratues të projekteve pranë Qendrës Kombëtare të Kinematografisë dhe nga Lidhja e Shkrimtarëve.

3. Për përzgjedhjen e 2 kandidaturave alternative për çdo vend anëtar të Këshillit Drejtues të RTSH-së, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik zbaton procedurën e mëposhtme:

Kandidaturat e administruara, në bazë të propozimeve të subjekteve përkatëse në Komision, i nënshtrohen përjashtimit një nga një deri në mbetjen e 2 të tillave, të cilat i propozohen seancës plenare. Procedura e përjashtimit zbatohet sipas radhës: një nga përfaqësuesit e maxhorancës parlamentare në Komision dhe një nga përfaqësuesit e opozitës.

4. Kandidaturat e propozuara nga subjektet e përcaktuara në shkronjat "b" dhe "c" të pikës 2 duhet të kenë grada ose tituj shkencorë.

5. Votimi në Kuvend bëhet i veçantë për çdo anëtar.

6. Në mënyrë që të sigurohet vijimësia e funksionimit të Këshillit Drejtues të RTSH-së, gjatë mandatit të parë të tij, Kryetari dhe 3 anëtarë të Këshillit Drejtues të RTSH-së zgjidhen në funksion për një periudhë 5-vjeçare, ndërsa 3 anëtarët e tjerë për një periudhë 3.5-vjeçare. Përcaktimi i mandatit të anëtarëve bëhet me short.”.

Neni 10

Neni 89 shfuqizohet.

Neni 11

Neni 90 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 90

1. Anëtarë të Këshillit Drejtues të RTSH-së nuk mund të jenë individët, që janë persona të lidhur ose kanë në pronësi vetjake kuota kapitali apo aksione të shoqërive tregtare, si dhe të drejta të tjera në fushën e transmetimeve radiotelevizive, reklamës, prodhimeve audiovizuale, botimeve të shtypit ose telekomunikacionit apo persona të punësuar ose anëtarë të organeve drejtuese apo këshilluese të këtyre subjekteve.

2. Anëtarë të Këshillit Drejtues të RTSH-së nuk mund të jenë individët, që janë larguar nga shërbimi civil apo funksioni si pasojë e një mase disiplinore.

3. Anëtarë të Këshillit Drejtues nuk mund të jenë personat punonjës aktualë të RTSH-së ose që kanë qenë punonjës të këtij institucioni tre vitet e fundit.”.

Neni 12

Neni 98 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 98

1. Kryetari dhe anëtarët e Këshillit Drejtues të RTSH-së përfitojnë një shpërblim fiks mujor për detyrën që kryejnë. Kuvendi cakton me vendim masën e shpërblimit të anëtarit të Këshillit Drejtues të RTSH-së. Kryetari përfiton një shpërblim 20 për qind më të lartë se shpërblimi i anëtarit.

2. Kuvendi cakton pagën dhe shpërblime të tjera të Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së.

Neni 13

Dispozitë kalimtare

Kuvendi, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ngre Këshillin e ri Kombëtar të Radios dhe Televizionit, sipas nenit 2 të këtij ligji dhe Këshillin e ri Drejtues të RTSH-së, sipas nenit 7 të këtij ligji.

Këshilli Kombëtar ekzistues i Radios dhe Televizionit dhe Këshilli Drejtues ekzistues i RTSH-së vazhdojnë veprimtarinë deri në konstituimin e organeve të reja.

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr.45, datë 19.6.2006

PËR MOSMIRATIMIN E DEKRETIT NR.4894, DATË 6.6.2006 TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS “PËR KTHIMIN E LIGJIT NR.9531, DATË 11.5.2006 “PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8410, DATË 30.9.1998 “PËR RADION DHE TELEVISIONIN PUBLIK E PRIVAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË””

Në mbështetje të nenit 85 pika 2 të Kushtetutës, si dhe të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Mosmiratimin e dekretit nr.4894, datë 6.6.2006 të Presidentit të Republikës “Për kthimin e ligjit nr.9531, datë 11.5.2006 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë””.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.362, datë 14.6.2006

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.456, DATË 3.7.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR STRUKTURËN DHE NIVELET E PAGAVE TË PUNONJËSVE TË
ADMINISTRATËS SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.456, datë 3.7.2003 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, lidhja nr.1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Në pikën 2, vlera “...9306 (nëntë mijë e treqind e gjashtë) lekë...” zëvendësohet me vlerën “...10 050 (dhjetë mijë e pesëdhjetë) lekë ...”.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2006, të përballohen nga fondet e planifikuara për rritjen e pagave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha
Lidhja nr.1

KLASA	KATEGORITË	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA E POZICIONIT
		1	2	3	4
		Paga e grupit (PG)	Shtesas vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP) lekë
	I-a	10 050	2%	0	80 342
II	II-a	10 050	2%	0	59 714
II	II-b	10 050	2%	0	43 428
III	III-a	10 050	2%	0	32 571

VENDIM

Nr.364, datë 14.6.2006

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.185, DATË 16.4.1993 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGAT DHE SHITESAT MBI PAGË TË USHTARAKËVE TË
SHËRBIMIT PYJOR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.185, datë 16.4.1993 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 2, lidhja nr.1 “Paga bazë sipas klasave për punonjësit ushtarakë të shërbimit pyjor”, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Në pikën 2 vlera “...11 800 (njëmbëdhjetë mijë e tetëqind) lekë...” zëvendësohet me vlerën “... 14 000 (katërmëdhjetë mijë) lekë...”, ndërsa vlera “... 28 000 (njëzet e tetë mijë) lekë...” zëvendësohet me vlerën “... 29 120 (njëzet e nëntë mijë e njëqind e njëzet) lekë...”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2006, të përballohen nga fondet e parashikuara për rritjen dhe reformën në sistemin e pagave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 korrik 2006.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

Lidhja nr.1

PAGA BAZË SIPAS KLASAVE PËR PUNONJËSIT USHTARAKË TË SHËRBIMIT PYJOR

Nr. rendor	Klasa	Paga bazë mujore në lekë
1	I	14000
2	II	14300
3	III	14500
4	IV	14800
5	V	15100
6	VI	15400
7	VII	15700
8	VIII	16000
9	IX	16200
10	X	16600
11	XI	16900
12	XII	17100

13	XIII	17300
14	XIV	17600
15	XV	17930
16	XVI	18370
17	XVII	18700
18	XVIII	19620
19	XIX	20900
20	XX	21800
21	XXI	22880
22	XXII	25000
23	XXIII	29120

VENDIM
Nr.365, datë 14.6.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.108, DATË 11.2.2005 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT, TË FUNKSIONIMIT DHE PAGAT E PUNONJËSVE TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.8610, datë 17.5.2000 “Për parandalimin e pastrimit të parave”, të ndryshuar, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.108, datë 11.2.2005 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:
 - a) Në pikën 7, lidhja nr.1 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 - b) Në pikën 7.1 vlera “... 9306 (nëntë mijë e treqind e gjashtë) lekë...” zëvendësohet me vlerën “... 10 050 (dhjetë mijë e pesëdhjetë) lekë...”.
 2. Të gjitha dispozitat, që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.
 3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2006, të përballohen nga fondet e planifikuara për reformën dhe rritjen e pagave.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

EMËRTIMI	KATEGORITË	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA E POZICIONIT
	1	2	3	4	5
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për kualifikim (SHP)	Shtesa për pozicion (SHP) lekë

			(SHK)		
Drejtor i Përgjithshëm	II-a	10.050	2%	0	97 713
Zv/drejtor i Përgjithshëm	II-b	10.050	2%	0	80 342
Drejtor	III-a/1	10.050	2%	0	49 942
Përgjegjës sektori	III-b	10.050	2%	0	43 428
Specialist	IV-a	10.050	2%	0	32 571
	IV-b	10.050	2%	0	21 714

VENDIM
Nr.366, datë 14.6.2006

PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË BURGJEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 12 të ligjit nr.8321, datë 2.4.1998 “Për Policinë e Burgjeve”, të ndryshuar, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Burgjeve të jenë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Paga bazë për gradë (kolona 3), e lidhjes nr.1, është niveli i pagës së punonjësit të Policisë së Shtetit, në përputhje me gradën, që ka fituar.

3. Shtesa për natyrë të veçantë pune dhe shërbimi (kolonat 4 e 5), të lidhjes nr.1, jepet sipas funksioneve të veçanta të Policisë së Burgjeve.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2006, të përballohen nga fondet e parashikuara për rritjen dhe reformën në sistemin e pagave.

5. Vendimi nr.54, datë 27.2.1992 i Këshillit të Ministrave “Për sistemin e pagave të Ministrisë së Rendit Publik”, të ndryshuar, duke filluar nga data 1 korrik 2006 nuk do të zbatohet për punonjësit e Policisë së Burgjeve.

6. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË BURGJEVE

ROLI	GRADA	PAGA BAZË PËR GRADË	SHITESA PËR NATYRË TË VEÇANTË PUNE E SHËRBIMI	
			Në funksion të policie të regjimeve të jashtme	Në funksion të policie të regjimeve të brendshme dhe transferim shoqërimet
1	2	3	4	5
Bazë	Agjent	29000	4000	7000

	Agjenti i I-rë	30180	4000	7000
	Asistent	31300	4000	8000
	Asistent i I-rë	32500	4000	8000
	Kryeasistent	33600	4000	8000
I mesëm	Nëninspektor	43300	4000	6000
	Inspektor	45600	4000	6000
	Kryeinspektor	51480	4000	6000
I lartë	Nënkomisar	63180	4000	6000
	Komisar	78390	4000	6000
	Kryekomisar	90090	4000	6000
Madhor	Drejtues	100 500	8000	
	Drejtues i I-rë	103 500	8000	

VENDIM
Nr.367, datë 14.6.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.21, DATË 7.1.2005 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, TË ORGANIKËS DHE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË KOMITETIT SHTETËROR PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE DHE TË KOMISIONEVE VENDORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “d” të nenit 16 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

7. Në vendimin nr.21, datë 7.1.2005 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 8, lidhja nr.1 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Në pikën 9 vlera “...9000 (nëntë mijë) lekë...” zëvendësohet me vlerën “... 10 050 (dhjetë mijë e pesëdhjetë) lekë...”.

c) Shkronja “a” e pikës 13, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Në Komitetin Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave:

- Këshilltar 90 113 lekë;
- Zëdhënës shtypi 53 199 lekë;
- Sekretar 31 485 lekë.”.

ç) Shkronja “b” e pikës 13, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) Në komisionet vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave:

- Kryetari 59 714 lekë;
- Anëtari 53 199 lekë.”.

2. Pika 15 shfuqizohet.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2006, të përballohen nga fondet e planifikuara për rritjen e pagave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

EMËRTIMI	KATEGORITË	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA E POZICIONIT
		1	2	3	4
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK) lekë	Shtesa për pozicion (SHP) lekë
Drejtor drejtorie	II-b	10 050	2%	0	80 342
Përgjegjës sektori në Komitetin Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të pronave	III-a	10 050	2%	0	59 714
Përgjegjës sektori në Komitetin Shtetëror. Specialist i nivelit të lartë në Komitetin Shtetëror.	III-b	10 050	2%	0	43 428
Specialist i nivelit të mesëm në Komitetin Shtetëror.	IV-a	10 050	2%	0	32 571
Specialist në Komitetin Shtetëror. Specialist në komisionet vendore	IV-b	10 050	2%	0	21 714

VENDIM
Nr.368, datë 14.6.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.56, DATË 27.2.1992 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHTESA MBI PAGË TË USHTARAKËVE TË SHËRBIMIT INFORMATIV KOMBËTAR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.56, datë 27.2.1992 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, lidhja nr.1 “Paga bazë sipas klasave për punonjësit e Shërbimit Informativ të Shtetit”, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Në pikën 1, vlera “... 11 800 (njëmbëdhjetë mijë e tetëqind) lekë ...” zëvendësohet me “...14 000 (katërmëdhjetë mijë) lekë ...”, ndërsa vlera “... 38 500 (tridhjetë e tetë mijë e pesëqind)

lekë...” zëvendësohet me “... 41 965 (dyzet e një mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë ...”.

c) Paragrafi i parë, i pikës 2/1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Paga mujore për funksionet e mëposhtme të jetë:

a) Inspektor i Përgjithshëm në Shërbimin Informativ të Shtetit 113 400 lekë;

b) Drejtor i Departamentit Informativ 94 450 lekë;

c) Drejtor drejtorie në aparatin qendror

Shef i kabinetit

Drejtor i Drejtorisë së Tiranës 86 850 lekë.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2006, të përballohen nga fondet e parashikuara për rritjen dhe reformën në sistemin e pagave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2006.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Lidhja nr.1

PAGA BAZË SIPAS KLASAVE PËR PUNONJËSIT E SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT

Nr. rendor	Klasa	Paga bazë Mujore në lekë
1	I	14000
2	II	14300
3	III	14500
4	IV	14800
5	V	15100
6	VI	15400
7	VII	15700
8	VIII	16000
9	IX	16200
10	X	16500
11	XI	16750
12	XII	17750
13	XIII	18000
14	XIV	18870
15	XV	21090
16	XVI	22200
17	XVII	23650
18	XVIII	26160
19	XIX	29700
20	XX	32700
21	XXI	36515

VENDIM
Nr.369, datë 14.6.2006

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË SISTEMIT TATIMOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, “Për kompetencat për përcaktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9464, datë 28.12.2005, “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të jenë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e degëve të tatimeve, në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të jenë sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Paga e grupit (kolona 1), Diplomë e shkollës së lartë, e lidhjeve nr.1 e nr.2, të jetë sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Shtesa për vjetërsi në punë (kolona 2), e lidhjeve nr.1 e nr. 2, të jepet në masën 2 për qind, pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën e grupit.

5. Shtesa për kualifikim (kolona 3), e lidhjeve nr.1 e nr.2, është 0.

6. Shtesa për pozicion është sipas kolonës 4, të lidhjeve nr.1 e nr.2.

7. Vendimi nr.437, datë 3.9.1993 i Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të tatime dhe të doganave”, i ndryshuar, shfuqizohet.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2006, të përballohen nga fondet e parashikuara për rritjen dhe reformën në sistemin e pagave dhe nga fondi limit i planifikuar për shpërblyerjet në sistemin tatimor.

9. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE

	POZICIONI	PAGA INDIVIDUALE			PAGA MUJORE		
		KATEGORIA	Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	Shtesa për kushte pune
Nr.			1	2	3	4	5
1	Drejtor i Përgjithshëm	II-a	1	2%		97713	13000
2	Zv/Drejtor i	II-b	1	2%		80342	13000

	përgjithshëm						
3	Drejtor Drejtorie	III-a	1	2%		59714	14000
4	Përgjegjës sektori	III-b	1	2%		43428	14000
	Përgjegjës zyre	III-b	1	2%		43428	12000
5	Inspektor i I-rë	IV-a	1	2%		32571	14000
6	Inspektor i II-të	IV-b	1	2%		21714	13000
7	Oficer i Policisë Tatimore	IV-a	1	2%		32571	15000
8	Nënoficer		2	2%		15750	9000
9	Llogaritar/Arkëtar		2	2%		17850	11000
10	Operatore		2	2%		15750	9000
11	Arshivist/Protokollist		2	2%		17850	10000
12	Magaznier		2	2%		15750	9000
13	Sekretare	IV-b	1	2%		21714	9000
14	Shofer		2	2%		15750	9000
15	Punonjës pastrimi		3	2%		12600	3000

Lidhja nr.2

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E DEGËVE TË TATIMEVE

PAGA MUJORE							
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)				Shtesa e pozicionit (SHP)	Shtesa për kushte pune
	POZICIONI	Kategoria	Paga grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	Shtesa për kushte pune
Nr.			1	2	3	4	5
Dega e tatimpaguesve të mëdhenj dhe dega e tatimeve Tiranë							
1	Kryetar dege	III-a	1	2%		59714	16500
	Nënkryetar dege	III-a/1	1	2%		49942	14000
2	Përgjegjës sektori	III-b	1	2%		43428	14000
	Përgjegjës zyre	III-b	1	2%		43428	12000
3	Inspektor i I-rë	IV-a	1	2%		32571	14000
4	Inspektor i II-të	IV-b	2	2%		21714	13000
	Oficer i Policisë Tatimore	IV-a	1	2%		32571	15000
5	Operator		2	2%		15750	9000
8	Llogaritar/Arkëtar		2	2%		21714	11000
11	Shofer		2	2%		15750	9000

14	Arshivist/Protokollist		2	2%		17850	10000
15	Magaznier		2	2%		15750	9000
16	Punonjës pastrimi			2%		12600	3000

Degët e tatimeve në rrethet e tjera

1	Kryetar dege	III-a/1	1	2%		49942	15000
2	Përgjegjës sektori	III-b	1	2%		43428	12000
3	Inspektor i I-rë	IV-a	1	2%		32571	12000
4	Inspektor i II-të	IV-b	2	2%		21714	11000
	Oficer i Policisë Tatimore	IV-a	1	2%		32571	14000
5	Operator		2	2%		15750	9000
	Llogaritar/Arkëtar		2	2%		15750	9000
	Shofer		2	2%		15750	9000
	Arshivist/Protokollist		2	2%		15750	9000
	Magaznier		2	2%		14700	9000
	Punonjës pastrimi			2%		12600	3000

Lidhja nr.3

Grupi	Diploma	Paga në lekë
1	Diplomë e shkollës së lartë	10050
2	Diplomë mbi shkollën e mesme	8950
3	Diplomë e shkollës së mesme	7000
4	Dëftesë lirimi (arsimi tetëvjeçar)	4500

Diploma mbi shkollën e mesme konsiderohen të gjitha diplomat e kurseve me program arsimor të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, mbështetur në legjislacionin në fuqi. Në këtë grup përfshihen gjithashtu, të gjithë ata që kanë mbaruar dy vite akademike të shkollës së lartë.

VENDIM Nr.370, datë 14.6.2006

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE TË ADMINISTRATËS SË PREFEKTIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2006”, me propozimin e Ministrisë të Brendshme dhe të Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Nivelet e pagave për funksionet e mëposhtme të jenë:

- | | |
|--|---------------|
| a) Prefekt i qarkut të Tiranës | 107 500 lekë; |
| b) Prefektë të qarqeve të tjera | 99 000 lekë; |
| c) Nënprefekt i Kavajës dhe Lushnjës | 84 000 lekë; |
| ç) Nënprefekt i Krujës, Pogradecit, Librazhdit, Tepelenës, Përmetit, Matit,
Sarandës, Pukës, Tropojës dhe Skraparit | 78 000 lekë ; |

- d) Nënprefekt i Malësisë së Madhe, Bulqizës, Peqinit, Gramshit, Devollit, Mallakastrës, Hasit, Kuçovës, Mirditës, Delvinës, Kurbinit dhe Kolonjës 72 000 lekë;
dh) Këshilltar i prefektit të Tiranës 55 000 lekë;
e) Zëdhënës i prefektit të Tiranës 45 000 lekë.

2. Struktura dhe nivelet e pagave për nëpunësit e administratës së prefektit janë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Paga e grupit (kolona 1) e lidhjes nr.1 – diplomë e shkollës së lartë është 10 050 (dhjetë mijë e pesëdhjetë) lekë.

4. Shtesa për vjetërsi pune (kolona 2) jepet në masën 2 për qind , pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

5. Shtesa për kualifikim (kolona 3) është 0.

6. Shtesa për pozicion është sipas kolonës 4 të lidhjes nr.1.

7. Nëpunësit, të cilët punojnë në pozicionet “Specialist” deri “Sekretar i Përgjithshëm”, që nuk përmbushin kriterin e arsimit të lartë të trajtohen me pagë sipas strukturës së përcaktuar në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, por paga e grupit të llogaritet me 50 për qind të pagës së grupit për diplomën e shkollës së lartë, sipas përcaktimit të bërë në pikën 3 të këtij vendimi. Shtesa për vjetërsi, për këta nëpunës të llogaritet mbi këtë pagë të reduktuar.

8. Nëpunësit e tjerë të administratës së prefektit të paguhen sipas lidhjes II-5 “Pagat bazë sipas klasave për punonjësit e ministrave dhe të institucioneve të tjera qendrore”, të vendimit nr. 726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, të ndryshuar.

9. Lidhja II-12, “Niveli i pagës për punonjësit e prefekturave”, e vendimit nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, të ndryshuar, dhe të gjitha dispozitat e tjera, që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

10. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2006, të përballohen nga fondet e planifikuara për rritjen e pagave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

EMËRTIMI	KATEGORIA	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHITESA E POZICIONIT
		1	2	3	
		Paga e grupit (PG) lekë	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV) përqindje	Shtesa për kualifikim (SHK) lekë	Shtesa për pozicion (SHP) lekë
Sekretar i përgjithshëm në prefekturë	III-a	10 050	2%	0	59 714
Sekretar i përgjithshëm në nënprefekturat Kavajë dhe Lushnjë	III-a/1	10 050	2%	0	49 942

Përgjegjës sektori në prefekturë	III-b	10 050	2%	0	43 428
	IV-a	10 050	2%	0	32 571
Përgjegjës zyre në prefekturë Përgjegjës zyre në nënprefekturë	IV-a	10 050	2%	0	32 571
Përgjegjës sektori në nënprefekturë Inspektor auditi në prefekturë	IV-a	10 050	2%	0	32 571
Specialist në prefekturë	IV-b	10 050	2%	0	21 714
	IV-c	10 050	2%	0	16 286
Specialist në nënprefekturë	IV-c	10 050	2%	0	16 286
Sekretar	IV-c	10 050	2%	0	16 286

VENDIM
Nr.371, datë 14.6.2006

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE, NË VARËSI TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE/KRYEMINISTRIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2006”, me propozimin e Ministrisë të Brendshme dhe të Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen: Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit, Agjencia e Prokurimit Publik, Instituti i Statistikave, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, Komiteti Shtetëror i Minoriteteve, Agjencia Telegrafike Shqiptare, Instituti i Integritetit të ish-të Përndjekurve Politikë.

2. Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve të institucioneve qendrore, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, janë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve të institucioneve rajonale/vendore, në varësi të institucioneve të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, janë sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Paga e grupit (kolona 1) e lidhjeve nr.1 e nr.2, - diplomë e shkollës së lartë, është 10 050 (dhjetë mijë e pesëdhjetë) lekë.

5. Shtesa për vjetërsi pune (kolona 2) e lidhjeve nr.1 e nr.2, jepet në masën 2 për qind, pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

6. Shtesa për kualifikim (kolona 3), e lidhjeve nr.1 e nr.2, është 0.

7. Shtesa për pozicion është sipas kolonës 4, të lidhjeve nr.1 e nr.2.

8. Për pozicionet “Përgjegjës sektori” dhe “Specialist” në sektorët teknikë të Agjencisë së Prokurimit Publik do të zbatohet shtesa, për kushte pune, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë.

9. Kategorizimi për secilin institucion për pozicionet “Përgjegjës sektori” dhe “Specialist” përcaktohet me urdhrin e miratimit të strukturës dhe organikës së institucionit.

10. Nëpunësit, që aktualisht punojnë në pozicionet “Specialist” deri “Titullar i institucionit”,

në institucionet rajonale/vendore dhe që nuk përmbushin kriterin e arsimit të lartë, të trajtohen me pagë sipas strukturës së përcaktuar në lidhjen nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, por paga e grupit të llogaritet me 50 për qind të pagës së grupit për diplomën e shkollës së lartë, sipas përcaktimit të bërë në pikën 4, të këtij vendimi. Shtesa për vjetërsi për këtë nëpunës llogaritet mbi këtë pagë të reduktuar.

11. Nëpunësit, që paguhen sipas lidhjeve nr.1 dhe 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi, dhe pikave 8 e 9, nuk përfitojnë shtesa të tjera, të përcaktuara me vendime të tjera të Këshillit të Ministrave.

12. Punonjësit e tjerë të paguhen sipas lidhjes II/M, “Paga bazë për punonjësit e ministrive, institucioneve të tjera qendrore dhe prefekturave”, dhe lidhjes II-5, “Niveli i pagave për punonjësit e ministrive, institucioneve të tjera qendrore dhe prefekturave”, të vendimit nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, të ndryshuar.

13. Të gjitha dispozitat, që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

14. Deri në datën 15.7.2006 duhet të ketë përfunduar procesi i ristrukturimit të institucioneve, që përfshihen në fushën e veprimit të këtij vendimi. Zbatimi i niveleve të pagave, të përcaktuara sipas këtij vendimi, të fillojë pas përfundimit të këtij procesi dhe miratimit, me urdhër të Kryeministrit, të strukturave dhe organikave të institucioneve të sipërpërmendura.

15. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2006, të përballohen nga fondet e planifikuara për rritjen e pagave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË INSTITUCIONET QENDRORE NË VARËSI TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE/KRYEMINISTRIT

	PAGA MUJORE				
POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA E POZICIONIT
		1	2	3	4
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Titullar i institucionit	II-a	10 050	2%	0	97 713
Zv/titullar i institucionit Drejtor drejtorie	II-b	10 050	2%	0	80 342
Anëtar i organit drejtues Koordinator	III-a	10 050	2%	0	59 714
Përgjegjës sektori	III-a/1	10 050	2%	0	49 942
Përgjegjës sektori Inspektor	III-b	10 050	2%	0	43 428
Specialist	IV-a	10 050	2%	0	32 571
	IV-b	10 050	2%	0	21 714

Lidhja nr.2

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE TË INSTITUCIONEVE
RAJONALE/VENDORE NË VARËSI TË INSTITUCIONEVE QENDRORE NË VARËSI TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE/KRYEMINISTRIT**

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA E POZICIONIT
		1	2	3	4
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Titullar i institucionit rajonal	III-b	10 050	2%	0	43 428
Titullar i institucionit vendor Përgjegjës sektori në institucionet rajonale	IV-a	10 050	2%	0	32 571
Përgjegjës sektori i institucionit vendor Specialist në institucionet rajonale	IV-b	10 050	2%	0	21 714
Specialist në institucionet vendore	IV-c	10 050	2%	0	16 286

**VENDIM
Nr.374, datë 14.6.2006**

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARIT TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILAT PREKEN NGA RIKONSTRUKSIONI I
RRUGËS SË LAGJES “DËLLINJË”, NË BASHKINË E GRAMSHIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561,
1800

datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rikonstruksioni i rrugës së lagjes “Dëllinjë”, në bashkinë e Gramshit.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Gramshit.
 3. Pronari i këtyre pasurive të paluajtshme të kompensohet në vlerë të plotë, prej 1 100 000 (një milion e njëqind mijë) lekësh sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 4. Ky fond të përballohet nga bashkia e Gramshit.
 5. Vlera e shpenzimeve procedurale është në shumën 56 000 (pesëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, dhe të përballohet po nga bashkia e Gramshit.
 6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 30.6.2006.
 7. Afati i përfundimit të punimeve të jetë brenda datës 5 gusht 2006.
 8. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Gramshit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR RIKONSTRUKSIONIN E RRUGËS TË LAGJES DËLLINJË NË BASHKINË GRAMSH

Nr.	Lloji i pronës që do të shpronësohet	Njësia e matjes	Sasia	Çmimi për njësi	Vlera në lekë	Emri i pronarit
1	Truall	m ²	200	2157.8	431560	Nevruz Riza Huta
2	Apartament	m ²	46.6	13137.6	612212	Nevruz Riza Huta
3	Dru frutor	copë	35		136440	Nevruz Riza Huta
	Nga këto:					
a	Kumbulla	copë	10		16600	
b	Pjeshkë	copë	15		23920	
c	Kajsi	copë	8		11960	
d	Fiq	copë	14		18510	
e	Ullinj	copë	1		13500	
f	Ftonj	copë	2		3200	
g	Hereke	copë	35		48750	
	SHUMA				1180212	

Masa e shpërblimit të miratuar me vendim të Këshillit të Bashkisë nr.7, datë 1.3.2006 dhe aktmarrëveshjes datë 13.4.2006 së nënshkruar ndërmjet kryetarit të bashkisë Gramsh dhe z.Nevruz Huta, qytetari që shpronësohet.	1 100 000	Nevruz Riza Huta
---	-----------	------------------

VENDIM
Nr.376, datë 14.6.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.205, DATË 13.4.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E DISPOZITAVE ZBATUESE TË KODIT DOGANOR
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, 14 e 16 të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “b.2” e pikës 11.7.1. “Procedura për ngritjen në kategoritë C2 dhe C1”, ndryshohet si më poshtë vijon:

“b.2. Komisioni i përzgjedhjes së kandidatëve për kategoritë C2 e C1 përbëhet nga:

- | | |
|--|----------|
| - zëvendësministri i Financave | kryetar; |
| - drejtori i Legjislacionit në Ministrinë e Financave | anëtar; |
| - drejtori i Legjislacionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave | anëtar; |
| - drejtori i Personelit dhe Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Financave | anëtar; |
| - një përfaqësues i Fakultetit Ekonomik | anëtar; |

Përfaqësuesi i Fakultetit Ekonomik propozohet nga dekanati i këtij fakulteti dhe miratohet nga kryetari i komisionit të përzgjedhjes.”.

2. Fjalja e parë e paragrafit të dytë të shkronjës “b.2” ndryshohet si më poshtë vijon:

“Përfaqësuesi i Fakultetit Ekonomik përfiton një shpërblim ditor, për çdo ditë pune në komision.”.

3. Shkronja “b” e pikës 11.8 “Procedura për ngritjen në kategoritë B e A”, ndryshohet si më poshtë vijon:

“b. Komisioni i përzgjedhjes për kategoritë B dhe A përbëhet nga:

- | | |
|--|----------|
| - zëvendësministri i Financave | kryetar; |
| - drejtori i Legjislacionit në Ministrinë e Financave | anëtar; |
| - drejtori i Legjislacionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave | anëtar; |
| - drejtori i Personelit dhe Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Financave | anëtar; |
| - një përfaqësues i Fakultetit Ekonomik | anëtar. |

Përfaqësuesi i Fakultetit Ekonomik propozohet nga dekanati i këtij fakulteti dhe miratohet nga kryetari i komisionit të përzgjedhjes.”.

4. Nën-pika 11.9.5 e pikës 11.9 “Procedura e rekrutimit nëpërmjet konkurrimit të hapur”, ndryshohet si më poshtë vijon:

“11.9.5. Komisioni i përzgjedhjes, për rekrutimin e nëpunësve, nëpërmjet konkurrimit të hapur, përbëhet nga:

- | | |
|--|----------|
| - zëvendësministri i Financave | kryetar; |
| - drejtori i Legjislacionit në Ministrinë e Financave | anëtar; |
| - drejtori i Legjislacionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave | anëtar; |

- drejtori i Personelit dhe Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Financave anëtar;
- një përfaqësues i Fakultetit Ekonomik anëtar.

Përfaqësuesi i Fakultetit Ekonomik propozohet nga dekanati i këtij fakulteti dhe miratohet nga kryetari i komisionit të përzgjedhjes.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.4, datë 14.6.2006

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.1, DATË 1.1.1996 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PROKURIMIN PUBLIK”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 5 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

Pika 3 e kapitullit I “Enti prokurues dhe urdhri i prokurimit” të udhëzimit nr.1, datë 1.1.1996 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Përcaktimi i fondit limit nga enti prokurues të bëhet në bazë të çmimeve të publikuara nga INSTAT-i, institucionet e tjera shtetërore përkatëse ose sipas testimi të tregut.

Nëse këto të dhëna nuk sigurohen nga burimet e mësipërme, enti prokurues mund të përdorë publikimet ndërkombëtare.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.34, datë 12.6.2006

PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, PËR VITIN 2005
PËR SHOQËRINË “EMIHEL” SHPK

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa b, 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, me ndryshimet e ligjit nr.9512, datë 10.04.2006 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe vendimit nr.60 datë 29.12.2004 të Bordit të Komisionerëve “Për miratimin e të dhënave bazë në lidhje me aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e vegjël”, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 12.06.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga “Emikel” sh.p.k., për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për vitin 2005,

VENDOSI:

1. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga “Emikel” sh.p.k., për periudhën nga 01.01.2005 deri më 31.12.2005, të jetë 4.52 lekë/kWh.

2. Ngarkohet “Emikel” sh.p.k. dhe KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

VENDIM
Nr.35, datë 12.6.2006

**PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, PËR VITIN 2005,
PËR SHOQËRINË “MAKSI ELEKTRIK” SHPK**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa b, 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, me ndryshimet e ligjit nr.9512, datë 10.04.2006 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe vendimit nr.60, datë 29.12.2004 të Bordit të Komisionerëve “Për miratimin e të dhënave bazë në lidhje me aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e vegjël”, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 12.06.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga “Maksi Elektrik” sh.p.k., për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për vitin 2005,

VENDOSI:

1. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga “Maksi Elektrik” sh.p.k., për periudhën nga 01.01.2005 deri më 31.12. 2005, të jetë 4.95 lekë/kWh.
 2. Ngarkohet “Maksi Elektrik” sh.p.k., dhe KESH sh.a, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

VENDIM
Nr.36, datë 12.6.2006

**PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË
LIDHJEVE TË REJA NË RRJETIN E SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9, 26, pika 1, dhe 27, pika 1 germa b, të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar me ligjin nr.9512, datë 10.04.2006 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.06.2006, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “KESH” sh.a. për tarifën e lidhjeve të reja në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Miratimin e metodologjisë për përcaktimin e tarifave të lidhjeve të reja në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, e bashkëngjitur këtij vendimi.
 2. Shfuqizimin e vendimit nr.17, datë 19.12.2001 “Për miratimin e udhëzimit mbi furnizimin me energji elektrike të përdoruesve të rinj”.
 3. Ngarkohet shoqëria “KESH” sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi më 1 shtator 2006 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

METODOLOGJIA PËR TARIFAT E LIDHJEVE TË REJA NË RRJETIN E SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

QËLLIMI

Kjo metodologji bëhet për të realizuar një unifikim të cilësisë së punimeve, standardeve dhe karakteristikave teknike të lidhjeve të reja të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

OBJEKTI

Kjo metodologji parashikon klasifikimin e kërkesave për lidhjet e reja për konsumatorin familjar në TU dhe për konsumatorin jofamiljar në TU, për lidhjet në tension të mesëm, si dhe për rilidhjet.

HYRJE

Domosdoshmëria për të pasur një metodologji të lidhjeve të reja vjen për shumë arsye, nga të cilat më kryesoret janë:

- Të gjitha punimet e lidhjes së re që bëhen në rrjetin shpërndarës të KESH-it duhet të bëhen nga vetë KESH-i apo operatorë të tjerë të kontraktuar nga KESH-i, sipas ligjeve në fuqi, duke respektuar në këtë mënyrë të gjitha standardet e cilësisë së materialeve, karakteristikat teknike sipas normave, seksionet e kabllove (në mënyrë që t'i përgjigjen lidhjeve edhe në të ardhmen). Kjo mënyrë do të eliminojë të gjitha të metat e vërejtura gjatë kohës në rrjetin shpërndarës elektrik për menaxhimin aktual apo perspektiv të tij.

- Duhet të bëhet mbi të gjitha respektimi me shumë rigorozitet i normave të sigurimit teknik, duke filluar me normat teknike që do të duhet të ndiqen në fazën e realizimit.

- Standardet e materialeve që do të përdoren, do t'i përgjigjen normave europiane IENC.

KAPITULLI I KRITERE TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Pagesa e lidhjes për çdo objekt apo grup objektesh sipas një plani urbanistik të caktuar, përcaktohet duke iu referuar këtyre treguesve:

- a) Fuqisë maksimale të kërkuar (P_k) të çdo konsumatori që kërkon të lidhet me energji elektrike. Për përdoruesit familjarë, fuqia e kërkuar që do të vihet në dispozicion nga ana e KESH sh.a., do të llogaritet me 10% shtesë për efekte të mbrojtjes me limitatorë;

- b) Largësisë minimale nga kabina më e afërt e transformacionit;

- c) Largësisë minimale nga n/stacioni më i afërt;

- d) Shpenzimeve administrative që bën furnizuesi për lidhjen me energji elektrike të konsumatorit.

Neni 2

Kërkesa dhe dosja për lidhjen me energji elektrike të një konsumatori duhet të përmbajë dokumentacionin e përshkruar në Kodin e Shpërndarjes, kapitulli IV (Lidhjet), pikat 4.1, 4.1.2, 4.2 dhe 4.2.1.

Zgjidhja teknike e furnizimit me energji elektrike duhet të ketë parasysh:

a) Tensioni i ushqimit, zgjidhja teknike e lidhjes dhe vendndodhja e pikës së dorëzimit të energjisë elektrike, përcaktohen nga ndërmarrja furnizuese (KESH) në bazë të situatës së rrjetit ekzistues të zonës, si dhe të fuqisë maksimale të kërkuar (P_k). Furnizimet e konsumatorëve të përhershëm me fuqi maksimale të kërkuar (P_k) deri në 30 kW përbëjnë lidhje në TU, me përjashtim të rasteve të veçanta të ndërtimeve të veçuara për të cilat nuk ekziston asnjë mundësi tjetër furnizimi.

b) Dorëzimi (pika e lidhjes) dhe matja e energjisë elektrike bëhet brenda territorit në pronësi (ose të marrë me qira) në pozicionin që lejon entin furnizues të kryejë funksionet e veta në përputhje me kontratën e furnizimit edhe në rastin kur mungon konsumatori. Në rastin e ndërtesave me më shumë njësi të paluajtshme (apartamente), dorëzimi (pika e lidhjes) dhe matja do të bëhet në ambientin e caktuar të përqendruar. Në rastet e pronave të rrethuara, pika e dorëzimit dhe e matjes do të vendosen në kurifin e pronësisë në mënyrë të përshtatshme dhe me hyrje të drejtpërdrejtë nga rruga e hapur për publikun. Në rastet kur dorëzimi dhe matja e energjisë bëhet brenda kufijve të pronësisë së ndërtesës, kërkuuesi është i detyruar t'i japë furnizuesit lejet dhe autorizimet e nevojshme, në momentin kur paraqitet kërkesa për lidhjen e energjisë elektrike.

c) Për pallatet e reja të banimit, në vartësi nga studimi që ka bërë furnizuesi (KESH-i) për furnizimin me energji elektrike, ndërtuesi është i detyruar të lërë një ambient të përshtatshëm për kabinë elektrike sipas kushteve teknike të instalimeve elektrike.

- Furnizuesi (KESH) do të hartojë projektin e kabinës elektrike dhe të furnizimit të saj nga linjat e tensionit të mesëm (TM).

- Furnizuesi (KESH) do të bëjë vendosjen e pajisjeve dhe të materialeve të tij në kabinën elektrike dhe do të kryejë edhe punimet për montimin e tyre.

- Për kabinën (pjesa ndërtimore) të bëhet “Shpronësim për intersa publike”, sipas legjislacionit në fuqi.

- Në qoftë se investitori i pallatit nuk planifikon lënien e një ambienti për kabinë elektrike kur është parashikuar në mënyrën e furnizimit, atëherë furnizuesi (KESH) nuk do t'i firmosë formularin e lejes së ndërtimit për furnizimin me energji elektrike.

d) Lidhja me energji elektrike e përdoruesit realizohet me linjë ajrore ose kabllore në vartësi të sistemit të shpërndarjes (ajror apo nëntokësor) që ka përdorur enti furnizues në atë zonë. Në qoftë se në zonat në të cilat rrjeti elektrik shpërndarës është ajror dhe lidhja e konsumatorit projektohet nga enti furnizues për t'u bërë me linjë nëntokësore, atëherë do t'i referohet tarfiave për lidhjen kabllore (nëntokësore).

e) Me pagesën e kostove të parashikuara, furnizuesi është i detyruar të ndërtojë rrjetin elektrik dhe pajisjet e nevojshme nga pika e furnizimit me energji elektrike deri në pikën e dorëzimit, përfshirë grupin e matjes, limitues ose tregues të fuqisë maksimale. Kërkuuesi duhet të vërë në dispozicion të furnizuesit vendin dhe hapësirën e përshtatshme (sipas kërkesave të furnizuesit) për instalimin e matjes dhe të pajisjeve të pikës së dorëzimit. Të gjitha punimet (ndërtimore) që bëhen për të bërë të mundur vendosjen e pajisjeve sa më sipër (si dhe vendi ku vendosen ato), janë në ngarkim të kërkuarit.

f) Çdo objekt që është i pandarë duhet të ketë vetëm një pikë dorëzimi (një pikë lidhje) të energjisë elektrike dhe për rrjedhojë i korrespondon një kontratë furnizimi me energji elektrike.

KAPITULLI II
LIDHJA ME ENERGJI ELEKTRIKE E PËRDORUESVE TË PËRHERSHËM OSE TË
PËRSËRITUR

Neni 4

Lidhja e përdoruesve (familjarë dhe jofamiljarë njëfazor apo trefazor) në TU

a) Përcaktimi i pagesës për një lidhje të re në TU do të përdoret nga shuma e tri tarifave të përcaktuara si më poshtë:

- Tarifa e distancës (T_d) që ka të bëjë me largësinë e konsumatorit nga kabina më e afërt e transformacionit TM/TU të furnizuesit.

Distanca do të matet në mënyrë radiale (distanca më e shkurtër) nga kabina e transformacionit më e afërt në hartat e entit furnizues, ku të jenë pasqyruar linjat, kabinat me të dhënat përkatëse (tipi, fuqia, viti i vënies në shfrytëzim) dhe të jetë azhurnuar në bazë të genplanit edhe objekti që do të furnizohet me energji elektrike.

Tarifat e pagesës për largësinë nga kabina TM/TU për linjat ajrore do të jetë si vijon:

Pagesa për këtë tarifë do të jetë 82 000 lekë për 200 m e para nga kabina e transformacionit dhe pastaj për 700 m e para do të rritet në 4 100 lekë për çdo 100 m distancë, nga 700 deri 1200 m do të rritet me 8 200 lekë për çdo 100 m distancë dhe për distanca më të mëdha se 1200 m do të rritet me 16 400 lekë për çdo 100 m distancë.

Tarifat e pagesës për largësinë nga kabina TM/TU për linjat ajrore jepen në tabelën e mëposhtme:

Largësia nga kabina TM/TU	Vlera e fiksuar e tarifës	Vlera e shtuar për çdo 100 m ose fraksione më të mëdha se 50 m
a) distanca 0-200 m	8 200 lekë	--
b) distanca 0-700 m - për 200 m e para - për një largësi të mëtejshme	8 200 lekë --	-- 4100 lekë
c) distanca 0-1200 m - për 700 m e para - për një largësi të mëtejshme	28 700 lekë --	-- 8200 lekë
d) distanca 1200 m e më tej - për 1200 m e para - për një largësi të mëtejshme	69 700 lekë --	-- 16 400 lekë

Tarifat e pagesës për largësinë nga kabina TM/TU për linjat kabllore do të jetë si vijon:

Pagesa për këtë tarifë do të jetë 18 000 lekë për 200 m e para nga kabina e transformacionit dhe pastaj për 700 m e para do të rritet me 9 000 lekë për çdo 100 m distancë, nga 700 deri në 1200 m do të rritet me 18 000 lekë për çdo 100 m distancë dhe për distanca më të mëdha se 1200 m do të rritet me 36 000 lekë për çdo 100 m distancë.

Tarifat e pagesës për largësinë nga kabina TM/TU për linjat kabllore jepen në tabelën e mëposhtme:

Largësia nga kabina TM/TU	Vlera e fiksuar e tarifës	Vlera e shtuar për çdo 100 m ose fraksione më të mëdha se 50 m
a) distanca 0-200 m	18 000 lekë	--
b) distanca 0-700 m - për 200 m e para - për një largësi të mëtejshme	18 000 lekë --	-- 9 000 lekë
c- distanca 0-1200 m - për 700 m e para - për një largësi të mëtejshme	63 000 lekë --	-- 18 000 lekë
d-distanca 1200 m e më tej - për 1200 m e para - për një largësi të mëtejshme	153 000 lekë --	-- 36 000 lekë

- Tarifa e fuqisë (T_f) përbën pagesën për çdo kW të fuqisë maksimale të kërkuar (P_k) dhe është e barabartë me 1500 lekë për kabinat ajrore dhe me 2500 lekë për kabinat tip boks (pa asnjë lloj ndryshimi nga lloji i furnizimit). Në rast lidhjeje të ndërtesave me më shumë se 4 njësi të paluajtshme (apartamente), pagesa e fuqisë bëhet duke marrë parasysh një fuqi të kërkuar prej 3.3 kW për çdo apartament.

- Tarifa fikse e lidhjes (T_l) është një pagesë fikse prej 3 250 lekësh dhe ka të bëjë me tarifën për matjen e rezistencës së tokëzimit prej 1000 lekë, azhurnimin e rrjetit prej 1250 lekësh, lidhja e energjisë elektrike prej 500 lekë dhe shpenzimet administrative prej 500 lekësh.

b) Në rastet kur një objekt është lidhur me energji elektrike dhe ndahet në më shumë se një pronar (përdorues të energjisë elektrike) kontratën për “Lidhjen e re” e trashëgon përdoruesi që i ka paguar detyrimet për të. Pronarët e tjerë, nëse duan të furnizojnë me energji elektrike pjesën e tyre të objektit, i nënshtrohen të gjitha detyrimeve që përmban ky udhëzim.

c) Për kërkesat që kanë të bëjnë me rritjen e fuqisë maksimale të kërkuar (P_k) në krahasim me atë që është lidhur kontrata, përdoruesi i detyrohet furnizuesit pagesat për tarifën e fuqisë (T_f) për P_k dhe tarifën fikse (T_l) prej 3 250 lekësh.

d) Për elektrifikimin e qendrave rezidenciale, të zonave të studiuara për vendndodhje të shumëllojshme industriale, artizanale dhe tregtare, kur furnizimi është i parashikuar në TU, aplikohen tarifat e këtij kapitulli edhe pse është e nevojshme të realizohen vepra të urbanizimit kryesor.

Që elektrifikimi të realizohet përpara lidhjes së secilit përdorues, kërkuuesi duhet të paguajë fillimisht tarifën e distancës (T_d). Në momentin e lidhjes së energjisë elektrike, përdoruesi paguan edhe tarifat e fuqisë dhe tarifën fikse 3 250 lekë.

Neni 5

Lidhja e përdoruesve në tension të mesëm deri 20 kV

a) Përcaktimi i pagesës për një lidhje të re në TM do të përbëhet nga shuma e tri tarifave të përcaktuara si më poshtë:

- Tarifa e distancës (T_d) që ka të bëjë me largësinë e konsumatorit nga n/stacioni më i afërt i furnizuesit. Distanca do të matet në mënyrë radiale (distanca më e shkurtër) nga n/stacioni më i afërt në hartat e furnizuesit ku të jenë pasqyruar linjat, n/stacioni me të dhënat përkatëse (fuqia, viti i vënies në shfrytëzim), dhe të jetë azhurnuar në bazë të genplanit edhe objekti që do të furnizohet me energji elektrike. Pagesa për këtë tarifë do të jetë:

Për linjat ajrore: 15 500 lekë për 500 m e para nga kabina e transformatorit dhe pastaj do të rritet me vlerën 3 100 lekë për çdo 100 m distancë; dhe

Për linjat kablllore: 49 000 lekë për 500 m e para nga kabina e transformacionit dhe pastaj do të rritet me 9 800 lekë për çdo 100 m distancë. Në rastet e distancave të ndërmjetme, p.sh. deri 150 m, pagesa do të jetë si për 100 m, ndërsa mbi 150 m do të jetë si për 200 m.

- Tarifa e fuqisë (T_f) përbën pagesën për çdo kW të fuqisë maksimale të kërkuar (P_k) dhe është e barabartë me 4 000 lekë.

- Tarifa fikse e lidhjes (T_l) është një pagesë fikse prej 3 250 lekësh dhe ka të bëjë me tarifën për matjen e rezistencës së tokëzimit prej 100 lekësh, azhurnimin e rrjetit prej 1250 lekësh, lidhja e energjisë elektrike prej 500 lekësh dhe shpenzimet administrative prej 500 lekësh.

b) Për kërkesat që kanë të bëjnë me rritjen e fuqisë maksimale të kërkuar (P_k), në krahasim me atë që është lidhur kontrata, përdoruesi i detyrohet furnizuesit pagesat për tarifën e fuqisë (T_f) 4 000 lekë për çdo kW të shtuar dhe tarifën fikse (T_l) prej 3 250 lekësh.

c) Për rastet kur një përdorues ka një kontratë në TU dhe kërkon shtesë fuqie, e cila sjell si domosdoshmëri kalimin në furnizim me TM, atëherë pagesa do të jetë e njëjtë si për çdo lidhje në TM, vetëm se llogaritja e tarifës së fuqisë do të bëhet vetëm për shtesën e fuqisë mbi atë ekzistuese që ka pasur konsumatori kur furnizohej me TU.

Neni 6

Udhëzime të përbashkëta

a) Largësia e caktuar në paragrafët e mëparshëm për përcaktimin e pagesës duhet të jetë e dukshme në planimetritë që përmbajnë vendndodhjen e kabinave TM/TU dhe të n/stacioneve, dhe janë të matura në vijë të drejtë me qendrën e kabinës ose të n/stacionit të cilit i jemi referuar deri në pikën e dorëzimit të energjisë elektrike. Në rastet kur në genplanin e paraqitur nga kërkuuesi nuk mund të gjykohej për largësinë e objektit nga kabina ose n/stacioni, atëherë kërkuuesi është i detyruar t'i paraqesë furnizuesit një planimetri të re nga ku mund të përcaktohet qartë largësia e objektit nga kabina apo (n/stacioni). Planimetritë që do të prëdoren për të përcaktuar largësinë e objektit nga kabina (n/stacioni), duhet të sigurohen nga furnizuesi dhe duhet të përmbajnë kabinat (n/stacionet), numrin që i dallon, muajin dhe vitin e hyrjes në shërbim. Elementet e mësipërme duhet të tregohen në një vend të posaçëm, në një pozicion të dukshëm nga jashtë kabinës.

b) Në faturat e shtypura nga furnizuesi për pagesat e lidhjes së re, në bazë të tarifave të këtij udhëzimi, duhet të jetë i treguar numri i kabinës (n/stacionit) të cilës i jemi referuar.

KAPITULLI III

LIDHJA ME ENERGJI ELEKTRIKE E PËRDORUESVE TË PËRKOHSHËM JO TË PËRSËRITUR

Neni 7

a) Pagesat për lidhjen e përdoruesve me furnizim të karakterit me kohëzgjatje të përkohshme, qoftë edhe më të madhe se një vit, por jo të përsëritur në vitet e mëpasshme, janë të përcaktuara si më poshtë:

b) Lidhje ose shtesë fuqie në TU do të paguhet tarifa e fuqisë prej 1 500 lekësh për kabinat ajrore dhe me 2 500 lekë për kabinat tip boks, për kW të fuqisë maksimale të kërkuar.

c) Lidhje ose shtesë fuqie në TM do të paguhet tarifa e fuqisë prej 4 000 lekësh për kW të fuqisë maksimale të kërkuar.

d) Për çdo veprim lidhjeje ose shkëputjeje të kërkuar jashtë orarit të punës do të paguhet një shtesë prej 1 500 lekësh.

KAPITULLI IV

RILIDHJA ME ENERGJI ELEKTRIKE E PËRDORUESVE SEZONALË MODIFIKIME KONTRAKTUESE, LIDHJE TË REJA, TRANSFERIME DHE TË ABONENTËVE QË U ËSHTË NDËRPRERË ENERGJIA PËR ARSYE DEBIE APO SHKELJE TË KONTRATËS

Neni 8

a) Rilidhja e përdoruesve sezonalë

- Pagesa për rivënien dhe shkëputjen e përdoruesve sezonalë me karakter të vazhdueshëm do

të jetë fikse, 3250 lekë.

b) Modifikime kontraktuale, lidhje të reja, transferime

- Pagesa për modifikime kontraktuale me kërkesë të përdoruesit që nuk sjellin rritje të fuqisë maksimale të kërkuar (P_k), që do të çonin në ndryshime tarifore, do të jetë në vlerën 3 250 lekë.

c) Për abonentët, të cilëve u është ndërprerë energjia për arsye debie apo shkelje të kontratës së energjisë elektrike, në momentin e rilidhjes së energjisë elektrike do të aplikohet pagesa:

- Pagesa për abonentët familjarë të jetë 500 lekë.

- Pagesa për abonentët privatë të jetë 1 000 lekë.

KAPITULLI V

PËRDORUES TË VEÇANTË DHE ZHVENDOSJE TË IMPIANTEVE ELEKTRIKE

Neni 9

Për lidhjen me energji elektrike të objekteve të vendosura jo në mënyrë të përhershme, të vendosura jashtë vendbanimeve (instalime të sinjalizimeve rrugore, repetitorë televizivë, impiante të mbrojtjes katodike, radiofonia, të transmetimit të të dhënave, stacione elektropompimi, vende për kafshët, magazina, e të ngjashme me to), ndërtime që nuk janë lehtësisht të hapura nga rruga e kalimit të automjeteve ose që janë të ndara nga impiantet e shpërndarjes ekzistuese me pjesë detare, liqene ose laguna, pagesa është fiksuar në masën 100% të shpenzimeve të ndërtimit të linjës elektrike.

Neni 10

Për lidhjen e ndriçimit dhe të reklamave, ndriçimit të monumenteve, impianteve të ngjitjes, instalime të përkohshme ose të lëvizshme (roulotess etj.) ndërtime të veçuara të pabanuara në mënyrë të përhershme ose sidoqoftë jo rezidenciale (vila, shtëpia për gjueti rifuxhio në male etj), të vendosura në më tepër se 2 000 metra nga kabina elektrike TM/TU së cilës i referohemi, kërkuuesi është i detyruar t'i rimbursojë furnizuesit shpenzimet përkatëse.

Neni 11

Zhvendosjet e pajisjeve elektrike dhe të grupit të matjes bëhen me kërkesë të përdoruesit dhe ky i fundit është i detyruar t'i rimbursojë furnizuesit shpenzimet përkatëse.

Neni 12

Me shpenzim përkatës kuptohet kostoja e dokumentuar e materialeve të veprës, përveç shpenzimeve të përgjithshme, të cilat konsiderohen të barabarta me 20% të vlerës së parathënë (shpenzime plotësuese që kryen furnizuesi).

KAPITULLI VI

NORMAT TRANZITORE

Neni 13

Këto tarifa nuk aplikohen për lidhjet e përcaktuara më parë se data e hyrjes në fuqi të kësaj metodologjie, ndërkohë që ekzekutimi i punimeve përkatëse nuk ka filluar në këtë datë. Konsiderohen të përfunduara lidhjet për të cilat detyrimi i pagesës së tarifave është derdhur ose është parashikuar në faturën përkatëse.

UDHËZIME PËRFUNDIMTARE

Neni 14

1. Vlerat e tarifave të përcaktuara në këtë udhëzim do të rishikohen në çdo kohë nga ERE, me

propozim të furnizuesit, duke u bazuar në lëvizjen e inflacionit.

2. Furnizuesi ka të drejtë të verifikojë edhe mbas lidhjes ekzistencën e kushteve në bazë të të cilave është përcaktuar pagesa. Në rastet kur nga ky verifikim konstatohet se personi që ka bërë aplikimin për lidhjen me energji elektrike i detyrohet furnizuesit (me përjashtim të rasteve kur vepra përbën objekt për ndjekje penale) vlerën respektive të diferencës së pagesës reale që i detyrohet dhe asaj të derdhur.

3. Në dosjen përkatëse të çdo lidhjeje duhet të shtohen edhe:

- a) Protokolli i tokëzimit;
- b) Akti i marrjes në dorëzim nga ana e furnizuesit (KESH);
- c) Procesverbal i vendosjes së matësit elektrik.

Neni 15

Detyrohen palët për respektimin e të gjitha akteve nënligjore të miratuara nga ERE.

Neni 16

Çdo normë juridike e paraqitur në këtë metodologji është objekt rishikimi dhe ndryshimi me miratim të ERE-s.

Neni 17

Shfuqizohet vendimi nr.17, datë 19.12.2001 “Për miratimin e udhëzimeve mbi furnizimin me energji elektrike të përdoruesve të rinj”.

Neni 18

Kjo metodologji hyn në fuqi më 1 shtator 2006 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr.37, datë 13.6.2006

PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “KURUM INTERNATIONAL” SHPK PËR TË QENË KLIENT TARIFOR

Në mbështetje të neneve 9, 43, pika 2 germa a, 45, pika 1, 48 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, ndryshuar me ligjin nr.9512, datë 10.04.2006 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, vendimi i Këshillit të Ministrave nr.539, datë 12.08.2004 “Për miratimin e modelit tranzitor të tregut të energjisë elektrike në Shqipëri” pika 1, pjesëmarrësit e tregut, germa h; pika 8, “Rregullatori i pavarur”, dhe rregullave të tregut të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.1, datë 25.01.2005, neni 9 pika 2, paragrafi i fundit, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.06.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e “Kurum International” sh.p.k. të shprehur në shkresën me nr.340 prot, datë 29.05.2006,

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së “Kurum International” sh.p.k. për të qenë klient tarifor.

2. Shfuqizimin e vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.17, datë 18.3.2005 “Për dhënien e statusit të klientit të kualifikuar shoqërisë “Kurum International” sh.p.k.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

VENDIM
Nr.38, datë 13.6.2006

**PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR AKTIVITETIN E IMPORTIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE SHOQËRISË “WONDER POWER” SHA**

Në mbështetje të nenit 13 pika 1 germa dh të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, ndryshuar me ligjin nr.9512, datë 10.04.2006 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe nenet 4 pika 1 germa g, nenit 5 pika 1 dhe nenit 16 pika 3 të “Rregullores për procedurat e licencimit” dhe duke konstatuar mosplotësimin tërësisht të dokumentacionit nga shoqëria lidhur me marrëveshjen paraprake për lejimin e tranzitimit të energjisë elektrike, dhe sa parashikon neni 15 i ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.06.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga “Wonder Power” sh.a. për marrje të licencës të importit të energjisë elektrike, konstatoi se nga tërësia e kërkesave të parashikuara në aktet e mësipërme, “Wonder Power” sh.a. ka plotësuar kryesisht kërkesat, por nuk ka plotësuar kushtin si më poshtë:

Në zbatim të Rregullores për procedurat e licencimit, neni 11 pika 5 dhe paragrafi 2,

- Lidhjen e marrëveshjes paraprake për lejimin e tranzitimit nga sistemet e transmetimit të shteteve nga ku importohet energjia.

Për sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Dhënien e licencës së importit, shoqërisë “Wonder Power” sh.a., me afat 1 vit.

2. Kjo licencë jepet me kusht që brenda 3 muajve nga marrja e vendimit, “Wonder Power” sh.a. të paraqesë në ERE marrëveshjen për lejimin e tranzitimit nga sistemet e transmetimit të shteteve nga ku importohet energjia.

3. Në përfundim të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, kjo licencë e humbet fuqinë juridike nëse nuk plotësohet kushti i vendosur për lidhjen e marrëveshjes së tranzitimit nga sistemet e transmetimit të shteteve nga ku importohet energjia.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 042 555 63; ose 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK	1500
(2006).....	
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
.....	
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET...(+ suplement 2006).....	1500
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I	1500
LEGJISLACIONIT.....	
2. TREGUESI TEMATIK I	2000
LEGJISLACIONIT.....	

Botime të reja

1. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
2. KODI	1000
DOGANOR.....	
3. KODI DETAR	1000
.....	

Hyri në shtyp më 26.6.2006
Doli nga shtypi më 28.6.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Ilar”
Tiranë, 2006

Çmimi 150 lekë